PROGRAMI I TRANSPARENCËS
BASHKIA DEVOLL

Funksionet e Bashkisë Devoll në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

Bashkia Devoll është përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.
Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.
Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike.
Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.
Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Përditësuar në datë 16.03.2026